Katalogu teknik IXHEM

Rr. “Vath Turja” , Vrinas, Durrës
Tel: 0694061948 / 0672028693
ixhem@info.al
www.ixhem.al

Ne themelet e nje lidershipi

E krijuar në vitin 2008 si rezultat i eksperiencës shumë vjeçare të themeluesve të saj me kompanitë më në zë të prodhimit parafabrikat në Itali, I.XH.E.M parafabrikat realizon konstruksione parafabrikate ne beton te armuar duke shfrytezuar plotesishte performacen e betonit me ane te teknologjise se paranderjes.

IXHEM parafabrikat mbulon te gjithe gamen e proceseve, nga projektimi ne zbatim. Per kete IXHEM eshte pajisur me nje personel te specializuar ne fushen e inxhinierise dhe arkitektures, pjese e studios teknike IXHEM Project.

1 Kompania IXHEM

Perse te na zgjidhni

Ixhem prodhon nje game te gjere produktesh, komponentesh dhe sistemesh konstruktive te afte per te permbushur cdo kerkese per ndertesa me destinacion industrial, tregetar, zyra, magazinim, infrastrukture, banim, kabina elektrike dhe mure rrethuese.

Te gjitha elementet dhe veprat e prodhuara nga IXHEM Parafabrikat, I pergjigjen normativave ligjore dhe sistemeve te kontrollit qe garantojne kualitetin dhe sigurine si ne prodhimet ne fabrike dhe ne punen ne katier.



Parafabrikati


Koncepti

Koncepti I struktures parafabrikat lind nga modularizimi I nje strukture, elementet perberese te se ciles jane te standartizuara dhe te prodhura ne pista ne fabrike (jo ne vendnodhjen perfundimtare te objektit) dhe me pas te transportuara dhe te montuara ne sheshin e ndertimit.


Prodhimi i elementeve

- Elementet parafabrikat prodhohen ne fabrike dhe me pas transportohen ne sheshin e ndertimit.
- Prodhimi ne kantier lejon rritjen e eficenses dhe nje kontroll cilesie me te larte.
- Perdorimi I formave me cilesi te larte (pistave te prodhimit) lejon nje kontroll te larte te cilesise se siperfaqes se perfunduar.
- Format metalike kane qendrueshmeri te larte, perdoren shume here duke eliminuar keshtu koston e formave te derdhura ne vend (ne ndertimet civile).
- Elementet strukturore perforcohen me kavo (pre tensionim) qe sjellin nje rritje te eficenses dhe qendrushmerise se struktures.

Ndërtim Civil



Ndërtim Parafabrikuar





Montimi i elementeve

- Ne sitin e ndertimit, elementet e parafabrikuara ngrihen me vinc dhe montohen me inserte specifike.
- E krahasuar me ndertimin civil, elementet e parafabrikuara shpejtojne kohe dhe nuk varen nga kushtet e motit.



Avantazhet

1.Kursim në kosto, materiale, kohë dhe fuqi punëtore.
2.Karpenteria dhe skelat nuk janë të nevojshme.
3.Instalimi i gjithë impianteve dhe finiturave mund të bëhet menjëherë.
4.Procesi si i prodhimit dhe i montimit është i pavarur nga moti.
5.Komponentet e prodhuar mbikëqyren të gjitha nga afër çka garanton cilësinë.
6.Garanton një punë të pastër dhe të thatë në vend (kantier).
7.Ofron mundësinë e ndryshimeve dhe ripërdorimit të elementëve
8.Arrihen lehtësisht format e sakta, përmasat dhe konturet e rregullta.
9.Saktësi të lartë dhe në parafabrikimin e seksioneve të hollë dhe komplekse.
10. Falë modularitetit ofrojne mundësinë për të akomoduar kërkesat e zgjerimit në të ardhmen
11. Zëvëndësimi lehtësisht i pjesëve në raste dëmtimi gjatë kohës së përdorimit.
12. Zvogelim I impaktit negativ ne mjedis.

Rezultati ideal...

Nga godinat me siperfaqe te vogel ne ato me siperfaqe te madhe, IXHEM parafabrikat per-shtatet me se miri me kërkesat e klientit duke garantuar cilësi dhe eficence ne projektet e cdo tipi apo dimensioni.

I madh/i vogel

Organizim fleksibel per cdo nevoje.

I thjeshte/kompleks

Efikasitet dhe pergjegjesi edhe ne projektet me ambicioze.



... ne sherbimet e ofruara.

1. Studim fizibiliteti

- Vleresim I cdo informacioni mbi zonen e ndertimit dhe perdorimi I tyre per projekt idene.
- Vleresim I I zones se ndertimit, perfshire studim gjeoteknik.
- Konsiderojme zgjedhje te ndryshme ne site te ndryshme (ne raste kur klienti kerkon konsulence) .
- Analize e zgjidhjeve baze mbi kerkesat e klientit.

2. Projektim arkitektonik

- Projekt arkitektonik I bazuar ne nevojat e klientit.
- Zgjedhja e elementeve parafabrikat qe do te perdoren (ne baze te hapesires se drites te nevojshme per shperndarjen ne plan dhe lartesine e shfrytezueshme)
- Zgjedhje e kompozimit dhe materialitetit ne fasade.
- Plane, prerje, fasada.
- Interier I nderteses – ekstra (ne baze te kerkeses se klientit)

3. Projektim strukturor

- Analiza strukturore e elementeve parafabrikat.
- Projektim I elementeve parafabrikat nga zyra jone e projektimit e drejtuar nga ing. Vincenzo Silistrini.

4. Prodhim

- Prodhim I elementeve ne baze te projektit inxhinierik.
- Cdo element eshte I prodhuar ne fabrike.
- Cdo element vendoset ne pisten perkatese ne baze te dimensionimit.
- Insertet vendosen ne cdo element duke ndjekur vizatiment strukturore.
- Kur elementet jane gati (kur eshte arritur marka e betonit e shenuar ne projektin strukturor) ngrihen nga pista.
- Cdo element siglohet (ne baze te projektit dhe nr. te elementit) dhe me pas pozicionohet ne zonen e stokazhit.

5. Transport

- Elementet qe do te transportohen ne kantierin e ndertimit, perzgjidhen nga zona e stokazhit ne baze te nje studimi te meparshem (ne baze te rradhes se montimit)
- Elementet e perfunduara transportohen me trailer ne vendndodhjen per-fundimtare.

6. Montim

- Elementet montohen ne vend nga grupi jone I montimit.
- Cdo element lidhet me tjerin me ane te inserteve.

7. Punime infrastrukturore

- Punimet e finitures jane punimet e fundit perpara dorezimit te objektit. Ato perfshijne pastrimin e fugave ndermjet paneleve, silikonimin e tyre, punime rregulluese etj.

8. Dorezim i objektit

- Godina parafabrikat eshte gati per perdorim!

Respektim i afateve

Dorezime te sigurta

Kohe te garantuara dhe te planifikuara sipas nje organizimi te paracaktuar.

Produkte te perfunduara

Prodhimi i elementeve ne katjer sjell kohe me te shkurtra dhe te kontrollueshme.

2000 m2 ne muaj

Kohezgjatje te sigurta per cdo lloj realizimi, nga ato me te medha, tek ato me te vogla.

Referenca

Cdo projekt i zbatuar ne kohe eshte nje tregues i punes tone.



Dizajn dhe fleksibilitet...

Projektim i integruar

Konsiderojme te rendesishem cdo hap te projektimit ne perputhje me deshirat e klientit.

Fleksibilitet

Reagim i shpejte ne kerkesat per azhornimet e projektit.

Pergjegjesi

Garancia per te pasur godinen e duhur per nevojat tuaja.

Individualitet

Cdo projekt ndiqet me kujdes dhe siguron individualitet dhe pershtatje me kerkesat e klientit.

...per cdo lloj realizimi.



Industrial

me një ose shumë kate për industrine e lehtë, prodhime fasone, përpunim mermeri, përpunim druri, përpunim metalesh, etj.

Magazinim

me një dhe shumë kate, për depo farmaceutike,
materiale elektrike, hidraulike, materiale ndërtimi, produkte bujqesore, produkte konsumi, etj., me dhe pa vinç ure.

Sherbime dhe zyra

me një ose shumë kate për zyra qendrore të kompanive, objekte shumëfunksionale me zyra të integruara, etj.

Tregtare

me një ose shumë kate për tregtimin e materialeve të ndryshme, supermarkete, autosallone, qendra tregtare, depo farmaceutike, etj.

Banim

me një ose më shumë kate për strehim njëfamiljar apo shumëfamiljar, vila, komplekse turistike, hotele, etj.

Infrastrukture

prodhim dhe montim trarë urash, mbikalime, etj.



Eficence

Sherbim i plote

Ne saje te kerkesave te klientit, ofrohet paketa e sherbimit te plote nga projekti arkitektonik e deri ne dorezimin fizik te struktures.

Eco - friendly

Minimizim i efekteve negative ne mjedis, ne pershtatje me normativat mjedisore.

Personel i specializuar

Personel i specializuar per fushat e projektimit, prodhimit dhe montimit.

Zgjedhje te personalizuara

Projekte ne pershtatje me cdo kerkese, duke ruajtur individualitetin.

2 Skedat teknike

Permbajtja

Kollonat

- Specifikime teknike

Tjegullat TT

- Variacione teknike

Tjegullat V

- Variacione teknike

Panelet

- Tipologjite

Traret TLP dhe TR

- Variacione teknike

Struktura TLP dhe TR

- Detaj : Kombinim elementesh ne strukturen TLP, TR
- Traret, tjegullat dhe insertistika
- Nyje : Kollone - tra - tjegull - panel

Traret I

- Variacione teknike

Struktura “Dopiopendence”

- Trau “Diamant”
- Detaj : Mbulesa “Dopiopendence”
- Variacionet teknike
- Nyje : kollone - tra - tjegull - panel

Struktura “Diamant”

- Nyje : kollone - tra - tjegull - panel
- Tjegulla “Diamant”
- Detaj : Mbulesa “Diamant”
- Variacionet teknike

Struktura “V”

- Tjegulla “V”
- Variacionet teknike

Shkallet e parafabrikuara

- Detaj : Shkalle parafabrikat

Kabine elektrike

- Shembull kabine elektrike

Muret rrethuese

- Shembull mure rrethuese



Kolonat e parafabrikuara

Kolonat e parafabrikuara jane elemete monolite vertikale te cilat kane avantazhin e nje prodhimi te shpejte pasi kane fleksibilitet ne dizajn dhe ne kosto. Prerja e tyre mund te jete drejtkendore ose katrore ne baze te ngarkeses qe ushtrohet.

Realizohen me beton të armuar të markës RCK-55 N/mm2 dhe çelik B450C N/mm2. Në gjatësinë e llogaritur përfshihet edhe pjesa që futet brënda gotës së plintit e parashikuar deri në 30cm nga dyshemeja e përfunduar në rastet normale, ose e llogaritur në varësi të thellësisë së plintit. Kolonat kanë në brëndësi të tyre tubat e shkarkimit të ujërave të tarracës të cilët zbresin deri në kuotën e -20cm.

Lartesia – variabel
Gjeresia – nga 50cm ne 80 cm.
Gjatesia – nga 50cm ne 80 cm.

Fleksibilitet

Me ane te “dhembeve” per nderkate dhe vinc ura, kolonat e parafabrikuara gjejne perdorim te gjere.

Perdorimi

Perdoren per te gjitha tipologjite e ndertesave, nga ato industriale ne ato civile.

Estetike

Siperfaqja e betonit eshte e lemuar.



Specifikime teknike

Kolonat ne baze te specifikave te perdorimit jane te pajisura me elemente kapese te ndyshme:

Inserte ankoruese

- ankoruse per fiksimin dhe kunderlevizjen e komponenteve strukturore si trare dhe panele.

Vinc - ura

- mensola per vinc-uren nga 5 ne 30 ton.


Nderkate


- mensola per nderkate qe mund te zhvillohen nga 2-3 deri ne 4 faqet e kollones.


Pluvialet


- pluvialet e inkorporuara per shkarkimin e ujrave te shiut.

Kollonat e 3 tipeve :
- kollone nderkati ku mbeshteten traret TLP dhe TR
-kollone anesore (setto) me mensol per vinc ure
- kollone qendrore me mensola per vinc ure ne te dy kampatat









Kolona dhe insertistika

Tjegulla TT

Tjegullat TT jane elemente te parafabrikuar te paranderur qe realizohen me beton te armuar te markes Rck-55N/mm², celik B450C N/mm² dhe kavo per paranderje me fptk 1860 N/mm².
Keto komponente jane idealet per mbulesa apo nderkate pasi mbulojne distance te konsiderueshme.

Gjatesi – max 30m.
Lartesi – max 100 cm.
Gjeresi – 250cm



Fleksibilitet


Mbulojne hapesira drite te konsiderueshme dhe ne forma te ndryshme.

Perdorimi

Perdoren per te gjitha tipologjite e ndertesave, nga ato industriale ne ato civile.

Design

Pershtatet me llojet e ndryshme te sistemeve duke dhene shumellojshmeri zgjidhjesh.




- Karakteristikat e tjegullave “TT” ne mbulese

Tipi TT	B	H	Lmax	R	Pesha
TT37	249	37	1400	60min	183
TT40	250	40	1450	60min	224
TT50	250	50	1750	60min	246
TT60	250	60	2050	60min	268
TT70	250	70	2400	60min	300
TT80	250	80	2800	60min	332
TT100	250	100	3200	60min	397


- Karakteristikat e tjegullave “TT” ne nderkat

Tipi TT	B	H	Lmax	R	Pesha
TT40	250	40	850	60min	224
TT50	250	50	1050	60min	246
TT60	250	60	1250	60min	268
TT70	250	70	1550	60min	300
TT80	250	80	1850	60min	332
TT100	250	100	2200	60min	397

TJEGULLA “TT” - VARIACIONE TEKNIKE



TT 50 tjegulla e nderkatit
L max = 1050 cm



TT 70 tjegulla e mbuleses
L max = 2400 cm

Panelet

Tipologji

Te disponueshem ne variantin vertikal,horizontal ose perdorim i kombinuar.

Perdorimi

Ideale per te gjitha llojet e ndertesave.

Performance

Lehtesi por pa hequr dore nga performanca.

Estetike

Shumellojshmeri teksturash, finiturash dhe ngjyrash.


Paretet (ose muret anësore) janë elementë të parafabrikuar me beton arme të markës RCK-40N/mm2 dhe çelik B450C N/mm2, me spesor 20cm të cilët vendosen vertikalisht të mbështetur në traun e themelit dhe të kapur në trarë , ose vendosen horizontalisht të kapur në kollonat e objektit.

Paretet përbëhen nga 10 cm beton i armuar dhe 10cm polisterol izolues ndërmjet dy shtresave të betonit. Koefiçienti i transmetim-it termik është 0,90W/m2.

Panelet jane te fiksuara ne strukturen fillestare (kollonat, traret) ose sekondare (TT) me ane te kapjeve horizontale (halfenave) ose vertikale.



Shembull konfigurim paneli horizontal













Kombinimet


Lidhja e paneleve krijon qendrueshmeri ne strukture.
Panelet horizontale dhe vertikale me njera - tjetren lidhen jo vetem me insertistike, por gjithashtu me elementin femer - mashkull qe rrit stabilitetin. Varianti kur paneli eshte i lemuar nga nje ane perdoret ne rast dritaresh ose dyersh.




Lidhja L - F



Lidhja M - F



Lidhja L - L



- Panele horizontale
Gjatesi – max 10 m.
Lartesi – max 3.0 m.
Gjeresi – 20-30 cm

- Panele vertikale
Gjatesi – max 3.0 m.
Lartesi – max 12m.
Gjeresi – 20-30 cm


- Panele kendore
Gjatesi – e variueshme
Lartesi – max 12m.
Gjeresi – 20-30 cm

Traret TLP dhe TR

Traret “TLP” te parafabrikuar mund te perdoren njekohesisht si trare te nderkatit dhe si trare te mbuleses. Traret vendosen ne mensolat ose ne koke te kollonave dhe lidhen me insertet perkatese.
Traret L jane elemente te parafabrikuar te paranderur qe realizohen me beton te armuar te markes Rck-55N/mm², celik B450C N/mm² dhe kavo per paranderje me fptk 1860 N/mm².

Perdorimi: Perdoren per nderkate dhe ne mbulesen “e sheshte” per godina nje ose shume kateshe te objekteve civile ose industriale. Keto trare kane forme L pasi perdoren ne anet e struktures si suport per elementin “TT”.


Gjatesi – nga 6 ne 13 m
Lartesi – min 72cm, max 110cm.
Gjeresi – 50/65 cm




Traret “TR” te parafabrikuar jane elementet karakteristike qe perdoren per suportin e soletave te nderkateve apo mbulesave. Dimensionet e ketyre trareve varen nga pesha qe ato mbajne dhe nga lartesia e kembes se “TT” se perdorur e cila varet nga hapesira e drites qe kerkohet te mbulohet.

Perdorimi: Perdoren per nderkate dhe ne mbulesen “e sheshte” per godina nje ose shume kateshe te objekteve civile ose industriale. Keto trare kane forme T pasi perdoren ne mes te struktures si suport per elementin “TT”.

Gjatesi – nga 6 ne 13 m
Lartesi – min 72cm, max 110cm.
Gjeresi – 80 cm







Variacioni i lartesise se traut (L/T) ne baze se lartesise se tjegulles “TT”.

	TT	Traret T/L
H (cm)	37	72
H (cm)	40	75
H (cm)	50	85
H (cm)	60	95
H (cm)	70	105

TRARET L/R - VARIACIONE TEKNIKE



TR 95 e kombinuar me TT60




TLP 85 e kombinuar me TT50


Struktura e “sheshte”

Struktura e “sheshte” eshte vecanerisht e keshillueshme per realizimin e godinave me aktivitete prodhuese te cilat shtrihen ne nje ose me shume nivele.


I gjithe sistemi eshte i karakterizuar nga perdorimi i tjegullave TT te cilat per shkak te nje game te gjere lartesish garantojn nje fleksibilitet maksimal. Paketa e mbuleses kompletohet me traret TLP,TR ose I, te afte per te mbajtur ngarkesa te konsiderueshme.

- Trare TLP, TR
- Trare I
- Tjegulla TT






1. panele te parafabrikuar
2. kolona
3. dhemb mbeshtetes per traun
4. tra TLP
5. tra TR
6. tjegulla TT




1 panele te parafabrikuar
2 kolona
3 dhemb mbeshtetes per traun
4 tra TLP
5 tjegulla TT

Detaj : Kombinim elementesh ne sistemin e “sheshte”


MBESHTETJE E TJEGULLES MBI TRA - DETAJI 1
SEKSIONI GJATESOR



MBESHTETJE E TJEGULLES MBI TRA - DETAJI 2
SEKSIONI TERTHOR



SEKSIONI



PAMJE




Shembull detaji “TT40”

Insertet e perdorura:
- Ganca ngritjeje
- Bokulla sigurie
- Halfen

Traret, tjegullat dhe insertistika





1 panele te parafabrikuar
2 kolona
3 dhemb mbeshtetes per traun
4 tra TLP
5 tjegulla TT


Nyje: kolone - tra - tjegull

Struktura “Dopiopendence”

Sistemi parafabrikat “Dopiopendece” eshte ndertuar per nevojat specifike ne kapanonet industriale.

Traret DP kane nje seksion me gjeresi 50/55 cm, per te rritur qendrueshmerine ne suportin ne maje te kollonave. Insertet ne koke te kollonave te cilet lidhen me traret DP japin nje lidhje te forte midis te dy elementeve duke siguruar nje grade te larte qendrueshmerie ndaj forcave te eres dhe te levizjes se vinc-ures.


Perdorimi: Perdoren ne mbulesat e objekteve industriale.



1. panele te parafabrikuar
2. kolona
3. trau “Dopiopendence”
4. tjegull “TT”
5. dhemb per kolonat anesore

Traret “Dopiopendence”

Tjegullat TT





Traret “Dopiopendence”

Trarët “Dopiopendence” janë elementë të parafabrikuar të pararendur që realizohen me beton të armuar të markës RCK-50N/mm2 dhe çelik B450C N/mm2 dhe kavo për paranderje me fptk I860 N/mm2.

Keto trare perdoren per realizimin e mbuleses. Sistemi “Dopiopendence” shoqerohet me tjegulla “TT” me lartesi te ndryshme. Traret mbeshteten ne kollonat anesore me ane te dhembit ne kollone.
Karakteristike e trareve DP eshte perdorimi i gjere ne ndertesat industriale.

Gjatesi – nga 12 deri ne 25 m.
Lartesi – max lartesise 196 cm.
Gjeresi – max 55cm

Fleksibilitet


Kombinimet e ndryshme japin zgjedhje te shumellojshme arkitektonike.

Perdorimi


Perdoren per te gjitha tipologjite e ndertesave, nga ato industriale ne ato tregetare.

Estetike


Krijohen hapesira arkitektonike te ndricuara, me linja te pastra dhe design te rregullt.



Nyje: tra - tjegull - panel




1. panele te parafabrikuar
2. kolona
3. dhemb mbeshtetes per traun
4. tra DP
5. tjegulla TT



SISTEMI “DOPIOPENDENCE” - VARIACIONET TEKNIKE


Ndryshimi i lartesise ne baze te gjatesise se elementit.

DP	L (cm)	H (cm)
DP14	1400	136
DP16	1600	146
DP18	1800	156
DP20	2000	171
DP22	2200	181
DP25	2500	196




Detaj : Mbulese “Dopiopendence”


MBESHTETJE E TJEGULLES MBI TRA - DETAJI 1
SEKSIONI GJATESOR




MBESHTETJE E TJEGULLES MBI TRA - DETAJI 2
SEKSIONI TERTHOR



SEKSIONI



PAMJE



Shembull detaji “TT37”

Insertet e perdorura:
- Ganca ngritjeje
- Bokulla sigurie
- Halfen

Trau DP, tjegullat dhe insertistika

Traret I

Traret parafabrikat “I” jane te projektuar ne menyre te tille qe te permbushin disa kushte si:
• Ti japin nje pamje me estetike struktures
• Te kene performance te larte ndaj zjarrit

Keto trare jane elemente strukturore te cilat mbulojne hapesira drite me te medha sesa traret “L” dhe “T”. Gjithashtu ata sherbejne si suport per mbulesen “e sheshte” dhe sistemin “Diamant”.

Perdorimi: Perdoren per nderkate dhe mbulesa ne godina nje ose shume kateshe te objekteve civil ose industrial.
Per te mbuluar hapesira te medha keto trare kombinohen me sistemin “Diamant” ose perdoren ne sistemin “e sheshte” si trare mbulese .

Gjatesia – nga 8 ne 30 m.
Lartesia – max 150 cm.
Gjeresia– max 55cm

Design

Ne pershtatje me pritshmerite, keto trare mbulojne hapesira drite te medha.


Perdorimi

Perdoren per tipologjite e ndryshme te ndertesave, nga ato industriale tek ato tregetare.


Fleksibilitet

Kombinimet ne sistem japin shumellojshmeri zgjedhjesh.






IF100A



IF100B




IF100C


TRARET I - VARIACIONET TEKNIKE

Traret I	Bcm	H cm
IF70	45-55cm	70
IF80	45-55cm	80
IF90	45-55cm	90
IF100	45-55cm	100
IF110	45-55cm	110
IF120	45-55cm	120
IF130	45-55cm	130
IF140	45-55cm	140
IF150	45-55cm	150
IR65	50 cm	65
IR70	50 cm	70
IR75	50 cm	75


DETAJ I LIDHJES SE TRAUT ME KOLONEN



SEKSIONI



DETAJ I MBESHTETJES




Trau I dhe insertistika

Struktura “Diamant”

Sistemi “Diamant” eshte pergjigje per kerkesat e klienteve me kerkues që janë gjithnjë në kërkim të funksionalitetit dhe cilësisë në mjedisin e punës, ndriçimit natyral dhe izolimit akustik. Ky sistem është mbi të gjitha zgjidhje për kërkesat e mbrojtjes ndaj zjarrit dhe për përmirësimin e aspektit estetik; të gjitha këto të kombinuara me vlera të larta qëndrueshmërie dhe kosto optimale te mirëmbajtjes dhe menaxhimit.

Elementi Diamant mund të vihet në vend duke u kombinuar me pllaka (lastrine), timpane dhe elemente qe lejojne driten si shade ose polikarbonat.



- Tjegullat “Diamant”
- Timpanet
- Lastrat
- Lucernai

1 panele te parafabrikuar


2 kolona


3 tjegulla “Diamant”

4 timpan

5 laster


6 tra l





1 panele te parafabrikuar
2 kolona
3 dhemb mbeshtetes per traun I
4 tra I
5 tjegulla “Diamant”
6 timpan
7 laster

Nyje: Kolone - Tra - Tjegull - Panel





Tjegulla “DIAMANT”


Tjegullat “Diamant” jane elemente te parafabrikuar,te pararendur qe realizohen me beton te armuar te markes CA Rck-55 N/mm², celik B450C N/mm² dhe kavo per paranderje me fptk 1860 N/mm². Keto tjegulla perdoren per realizimin e mbuleses. Tjegullat Diamant shoqerohen me timpane dhe pllake per te mbushur hapesiren midis.

Fleksibiliteti në dimensione për strukturën e realizuar si një monobllok me bazë të gjerë dhe me qendrueshmëri të lartë, lejon mbulimin e sipërfaqeve të dritës që varion nga 12 deri në 26 metra sipas moduleve të objektit.

Gjatesi – nga 12 ne 26 m
Lartesi – max 1.6 m
Gjeresi – max 2.53 m







Zgjidhje te shumta ne mbulese

Design

Ne pershtatje me pritshmerite me te medha, ky sistem ofron nje design konkurues, me linja te pastra.

Perdorimi

Perdoren per tipologjite e ndryshme te ndertesave, nga ato industriale tek ato tregetare.

Fleksibilitet


Fleksibilitet ne konfigurim dhe dimensione per ti sherbyer klientit.

Qendrueshmeri

Struktura dhe materialet e perdorura te elementit tjegull bejne qe te kete nje qendrueshmeri te larte.


Keto elemente jane pjese e sistemit “Diamant” I perdorur si mbulese ne godina industriale dhe tregtare ne kombinim me timpanet dhe shade ose polikarbonat per ndricim. Keto kombinime mundesojne nje cilesi vizuale te larte te godines.

Perdorimi: Perdoren te kombinuar me timpanet dhe shade ne sistemin “Diamant”.



Timpanet


Gjatesi – 120cm
Lartesi – min 22cm dhe max 57cm.
Gjeresi – 250cm



Lastra


Gjatesi – e variushme
Lartesi – 5cm
Gjeresi – 250cm





1 panele te parafabrikuar
2 kolona
3 tra I
4 tjegulla “Diamant”
5 timpan
6 laster
7 polikarbonat

Detaj : Mbulese “Diamant”



SISTEMI “DIAMANT” - VARIACIONE TEKNIKE


Ndryshimi i lartesise ne baze te gjatesise se elementit.


DPD	H	L
DPD12	81	1200
DPD14	87	1400
DPD16	93	1600
DPD18	99	1800
DPD20	105	2000
DPD22	111	2200
DPD24	117	2400
DPD26	123	2600

Struktura “V”

Struktura “V” eshte nje zgjidhje e cila lejon krijimin e hapesirave arkitektonike me cilesi te larte, vecanerisht per efektin e ndricimit qe krijohet. Kjo strukture perbehet nga disa elemente te kombinuara per te krijuar nje mbulese moderne.

- Tjegulla V
- Trare I
- Lastra
- Kupole
- Amortizues





1 panele te parafabrikuar
2 kolona
3 tjegulla “V”
4 kupole
5 laster
6 tra l

Tjegulla “V”

Tjegulla “V” eshte nje zgjidhje e cila lejon krijimin e hapesirave arkitektonike me cilesi te larte, vecanerisht per efektin e ndricimit qe krijohet. Forma e trareve te ketij sistemi eshte “V” nga ku merr dhe emrin.

Si ne sistemin “V”, ky sistem mund te kete konfigurime te ndryshme ne baze te alternimit te elementeve solide me ato te drites. Mbulesa mund te kompletohet me nje shtrese hidroizoluese.

Gjatesi – max 24 m
Lartesi – 95 cm
Gjeresi – 250 cm

Fleksibilitet


Konfigurime te ndryshme te mbuleses ne baze te nevojave te klientit.

Perdorimi


Perdoren per te gjitha tipologjite e ndertesave, nga ato industriale ne ato tregetare.

Estetike


Krijon hapesira te medha, estetike, plot drite, me linja te pastra dhe dizajn modern.




PAMJE ANESORE




PAMJE NE PLAN





TV 95 variacionet teknike



TV 95 TIPOLOGJITE
10-24m

Tjegulla “V” dhe detajet teknike

Shkallet e parafabrikuara

Fleksibilitet

Thjeshtesi ne ndertim dhe montim. Pershtatje me lartesi te ndryshme katesh.

Perdorimi


Perdoren per te gjitha tipologjite e ndertesave, nga ato industriale ne ato civile.

Estetike


Element estetik, monobllok dhe i dizenjuar ne baze te kerkesave te klientit.

Shkallet parafabrikat jane zgjidhja ideale me cilesi te larte dhe ne kohen minimale.
Elementi parafabrikat I shkalleve se bashku me kembeshkeljen mund te dizenjohen ne baze te nevojave te hapesires qe klienti kerkon ne projekt.


Gjatesi – nga 28 cm ne 31 cm
Lartesi – lartesia min 17cm dhe lartesia max 19 cm.
Gjeresi – 120cm




Detaj: Shkalla parafabrikat




1 kolona
2 shkalle parafabrikat
3 muri i shkalleve
4 tjegull TT



A Nyje shkalle - tra - tjegull




B Nyje shkalle - sheshpushim



C Nyje shkalle - mure shkallesh

Kabine elektrike e parafabrikuar

Kabinat eleketrike jane elemente te perbere nga kater mure te kombinuara me nje cati dhe dysheme monolite. Keto elemente disponohen ne dimensione te ndryshme ne baze te nevojes se klientit.
Kabinat jane te ndertuara ne beton te vibruar, te montuara ne baze te kerkesave. Ne prodhim perdoret beton C45 I cili siguron qendrueshmeri dhe rezistence te larte. Ventilimi natyral brenda kabines behet me ane te dritareve te cilat eliminojne kondensimin.




Fleksibilitet

Thjeshtesi dhe shpejtesi ne ndertim dhe montim.


Estetike

Element estetik, monobllok dhe i modifikueshem ne baze te kerkesave te klientit.


PLANIMETRIA




PAMJA B




PAMJA D



PAMJA C



PAMJA A




Mure rrethuese te parafabrikuar

Muret rrethuese jane elemente monolite te perbera nga pjesa e murit dhe nga plinti parafabrikat. Dimensionet jane te vari-ueshme ne baze te perdorimit. Gjatesia e mureve te rrethimit perbehet nga module muresh me nje gjatesi maksimale prej 8m per cdo modul, te kombinueshme sipas kerkesave te klientit.
Muret rrethuese te prodhuara kane konfigurime te ndryshme duke filluar nga mure te plota (solide) dhe deri tek konfigurimet ku muret kane hapje te vazhdueshme (transparente).

Perdorimi: Perdoret ne godina industriale ose civile per rrethimet e jashtme.

Gjatesia modulit – max 8 m.
Lartesia – max 2.65 m, e perdorshme 2.4 m.
Gjeresia – 12 cm



Fleksibilitet

Thjeshtesi ne ndertim dhe montim.


Estetike

Element estetik, monobllok dhe i modifikueshem ne baze te kerkesave te klientit.


Shembull mure parafabrikat

Muri Tip 2


Prerje anesore




Pjesa e siperme



Pamja nga Siper



Muri Tip 1



Ndertimet industriale jane projekte qe kane ne baze te tyre funksionalitetin qe perfshin sigurimin e hapesirave te medha te punes per kryerjen e aktiviteteve specifike. Por pronaret e ketyre objekteve jane gjithashtu te vetedijshem se sa i rendesishem nje imazh terheqes mund te jete. Prodhimi ne parafabrikat ndihmon ne permbushjen e ketyre kerkesave duke kombinuar me se miri funksionalitetin me nje design modern.

3 Realizime

IXHEM PARAFABRIKAT

SFIDAT E DESIGN-IT	ZGJIDHJET NE PARAFABRIKAT
Te projektohet nje eksterier terheqes dhe i qendrueshem i cili pershtatet me zonen.	Panelet e parafabrikuara perdorin ngjyra dhe tekstura qe pershtaten me cdo design.
Te siguroi nje interier te hapur.	Perdorimi i tjegullave TT lejon hapesira te medha drite te cilat bejne te mundur krijimin e nje hapesire arkitektonike te hapur,me nje numer te vogel kolonash, krahasuar me ndertimin civil.
Instalimi i pedanave te ngarkim / shkarkimit.	Konfigurimi i fasades me panele te parafabrikuara horizontale dhe vertikale, lejon krijimin e hapesirave per portale (dyer) dhe pedana ngarkuese.
Mundesia e zgjerimit ne te ardhmen.	Nese nje ndertim industrial, tregetar ka nevoje te zgjerohet, parafabrikati jep mundesine me ane te elementeve te tij fleksibel,ne cdo kohe te jete e mundur shtimi i nje ose me shume kampatave.
Minimizimi i punes ne kantier.	Elementet parafabrikat prodhohen ne fabrike ne kushte optimale dhe transportohen ne kantierin e ndertimit duke minimuzuar punen ne kantier dhe komplikimet qe lindin ne te.
Shkurtimi i kohes se ndertimit.	Prodhimi i elementeve te parafabrikuara ben te mundur shkurtimin drastik te koherave te ndertimit.
Siguria mbi cilesine.	Prodhimi i elementeve ne fabrike, ne pistat e prodhimit, lejon nje kontroll te larte te cilesise si gjate prodhimit, edhe mbas tij.



Objekte Magazinimi

me një dhe shumë kate, për depo farmaceutike, materiale elektrike, hidraulike, materiale ndërtimi, produkte bujqesore, produkte konsumi, etj., me dhe pa vinç ure.

• VERTIGO

Klienti: Vertigo

Tipologjia: Objekt Magazinimi

Siperfaqe: 4098 m²

Viti: 2015

Statusi: I perfunduar

Pershkrimi : Objekt parafabrikat me 1 kat me mbulese dopi-opendence, me destinacion magazinim.

Struktura :







me një dhe shumë kate, për depo farmaceutike, materiale elektrike, hidraulike, materiale ndërtimi, produkte bujqesore, produkte konsumi, etj., me dhe pa vinç ure.

- **OBM 1, 2, 3**

Tipologjia: Objekte magazinimi

Siperfaqe: 4425 m²

Viti: 2015-2016

Statusi: Te perfunduara

Pershkrimi : 3 Objekte parafabrikat me 2 kate me mbulese dopiopendence, me destinacion magazinim.

Struktura :







me një dhe shumë kate, për depo farmaceutike, materiale elektrike, hidraulike, materiale ndërtimi, produkte bujqesore, produkte konsumi, etj., me dhe pa vinç ure.

• OBM 4

Tipologjia: Objekt magazinimi


Siperfaqe: 5101 m²

Viti: 2015

Statusi: I perfunduar

Pershkrimi : Kapanon parafabrikat me 2 kate, ku nderkati zyrave ka nje strukture me trare TLP 72 dhe TT37, ndersa mbulesa eshte e perbere nga struktura “Diamant” dhe trare IF 70B, IF 100B. Ky kapanon ka trare vinc - ure.

Struktura :







me një dhe shumë kate, për depo farmaceutike, materiale elektrike, hidraulike, materiale ndërtimi, produkte bujqesore, produkte konsumi, etj., me dhe pa vinç ure.

• ATLANTIC 3

Klienti: Atlantic 3

Tipologjia: Objekt magazinimi


Siperfaqe: 1100 m²

Viti: 2015

Statusi: I perfunduar

Pershkrimi : Objekt parafabrikat 1 kat + zyra 3 kate ku pjesa me 1 kat ka mbulese dopiopendence dhe TT40 ndersa pjesa e zyrave me 2 kate ka nje strukture me trare TLP 75 dhe TT 40.

Struktura :





Objekte Magazinimi

me një dhe shumë kate, për depo farmaceutike, materiale elektrike, hidraulike, materiale ndërtimi, produkte bujqesore, produkte konsumi, etj., me dhe pa vinç ure.

• IDK

Klienti: IDK sh.p.k

Tipologjia: Objekt magazinimi


Siperfaqe: 1752 m²

Viti: 2015

Statusi: I perfunduar

Pershkrimi : Objekt parafabrikat 1 kat + zyra 3 kate ku pjesa me 1 kat ka mbulese me trare IF70B dhe TT37 ndersa pjesa e zyrave me 3 kate ka nje strukture me trare TLP 72,TR72 , dhe TT 37 .

Struktura :




ALBAMER

• ALBAMER 1

Klienti: Albamer sh.p.k

Tipologjia: Objekt industrial


Siperfaqe: 2251 m²

Viti: 2014

Statusi: I perfunduar

Pershkrimi : Objekt parafabrikat me 2 kate, me strukture dopiopendence dhe TT ne kapanon dhe TLP dhe TT ne nder-katin e zyrave. Ky objekt ka trare vinc – ure dhe ka funksion perpunimin e gureve dekorativ.

Struktura :





me një ose shumë kate për indus-trine e lehtë, prodhime fasone, përpunim mermeri, përpunim druri, përpunim metalesh, etj.



• SALILLARI

Klienti: Salillari

Tipologjia: Objekt industrial

Siperfaqe: 1824 m²

Viti: 2012

Statusi: I perfunduar

Pershkrimi : Objekt parafabrikat me 1 kat me mbulese dop-iopendence dhe TT37.

Struktura :







me një ose shumë kate për industrine e lehtë, prodhime fasone, përpunim mermeri, përpunim druri, përpunim metalesh, etj.



• ENDI SH.P.K

Klienti: Endi sh.p.k

Tipologjia: Objekt industrial


Siperfaqe: 7088 m²

Viti: 2014

Statusi: I perfunduar

Pershkrimi : Objekt parafabrikat 2 kate + zyra 4 kate ku pjesa me me 2 kate e kapanonit perbehet nga trare TLP, TR dhe TT37 ne nderkat dhe ne mbulese me trare I dhe TT37, ndersa pjesa e zyrave me 4 kate ka nje strukture me trare TLP , TR , TT 37 ne nderkat dhe mbulese.

Struktura :





me një ose shumë kate për industrine e lehtë, prodhime fasone, përpunim mermeri, përpunim druri, përpunim metalesh, etj.



• ENERGY & AIR

Klienti: Energy & Air sh.p.k

Tipologjia: Objekt tregtar


Siperfaqe: 821 m²

Viti: 2013

Statusi: I perfunduar

Pershkrimi : Kapanon parafabrikat per tregtim materialesh me 2 kate me strukture me trare TLP, TR dhe TT ne nderkat dhe ne mbulese trare IR dhe TT.

Struktura :





me një ose shumë kate për tregtimin e materialeve të ndryshme, supermarkete, au-tosallone, qendra tregtare, depo farmaceutike, etj.


VOLVO

• MEKTRIN 1

Klienti: Mektrin Motors

Tipologjia: Objekt tregtar


Siperfaqe: 1740 m²

Viti: 2016

Statusi: Ne proces

Pershkrimi : Objekt parafabrikat me 2 kate, ku nderkati zyrave ka nje strukture me trare TLP 95 dhe TR 95 dhe TT60, ndersa mbulesa eshte e perbere nga trare TLP 75 dhe TR 75 dhe TT40. Ky objekt do te perdoret si showroom per kompanine “Mektrin Motors”.

Struktura :





me një ose shumë kate për tregtimin e materialeve të ndryshme, supermarkete, autosallone, qendra tregtare, depo farmaceutike, etj.

PARAFABRIKAT

IXHEM PARAFABRIKAT

IXHEM PROJECT